



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.131/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Selim Mehmeti, zyrtar i lartë komunal i zgjedhjeve në Komunën e Novobërdës, paraqitur kundër Lista Serbe, dega në Novobërd, për shkak të vendosjes së posterave në shenjat e trafikut publik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Selim Mehmeti, nga Novobërda, kështu që subjektit politik Lista Serbe, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,400.00 (njëmjëekatërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e marrjes-pranimit të këtij vendimi, **nën kërcënim të përmbaarimit**.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 07.06.2017, ka pranuar një ankesë Selim Mehmeti, zyrtar i lartë komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Novobërdës, me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017, është bërë mbulimi i shenjës së komunikacionit, në fshatin Prekovic si dhe vendosja e posterave në afërsi të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve dhe Komunës. Në cilësi të dëshmitarëve ka propozuar Policinë e Kosovës në Novobërdë dhe KKZ në Novobërd.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të ankesës A.nr.131/2017, të datës 07.06.2017, vlerësoj se e njëjta nuk i plotëson kushtet për shqyrtim, pasi që nuk përmban kryesin e supozuar dhe provat me të cilat pretendohet se janë vendosur në vende të palejuara dhe se të njëjtën ia kthej në plotësim parashtruesit të ankesës duke i kërkuar që të bëj plotësimin deri me datën 08.06.2017, në ora 10.00.

Parashtruesi ka bërë plotësimin e ankesës me datën 07.06.2017, në të cilën si kryes të supozuar ka shënuar Listën Serbe, dega në Novobërd, po ashtu plotësimin në ankesë i ka bashkëngjitur tre fotografi, lidhur me shkëljen e supozuar. Me këtë pretendon se këto veprime janë në kundërshtim me ligjin 03/L-073, nëni 33, pika b, Rregulla zgjedhore nr.11/2013, të nenit 3, pika b.

PZAP-i, me shkresën nr.131/4 të datës 07.06.2017, Listës Serbe i dërgoj kërkesë për përgjigje me urdhër për përmirësim, të cilën e kanë pranuar me datë 08.06.2017, në ora 9.55. Përkundër faktit se Lista Serbe e ka pranuar kërkesën për përgjigje me urdhër ndaj të njëjtës nuk është përgjigjur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimt, ka konstatuar se posterat e Listës Serbe, janë vendosur në shenja të trafikut publik.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se Lista Serbe ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike”*

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vndimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektei politik Lista Serbe, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterat e Listes Serbe janë vendosur në shenja të trafikut publik.

Paneli po ashtu vlerësoi me rastin e vendosjes, lidhur me gjobën e shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, mospërpjekjet e Listes Serbe për të ndërmarrë masa përmirësuese për evitimin e shkeljes së kodit të mirësjelljes, duke mos u përgjigjur dhe duke mos i larguar posterët nga vendet e palejuara ku ishin të vendosur.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.131/2017 më datën 09.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit**

Rafet Haxhaj

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.